



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:188797
Datë: 06.03.2024
Numri i dokumentit: 05418259

Ac.nr.8648/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin, Delushe Halimi, e me bashkëpunëtoren profesionale, Arjeta Sylja, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit, E.S. nga Gj., të cilën e përfaqëson bashkëshortja K.S. si trashëgimtare, e të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat M. M. nga Gj., kundër debitorit NSH."Ç." (në likuidim) përfaqësuar nga B.Sh., Kryesues i Autoriteti të Likuidimit në emër të AKP-së, Zyra Regjionale në Gj., me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm CP nr.797/22, të datë 04.11.2022, jashtë seance me datë 06.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kreditorit E.S. nga Gj., të cilën e përfaqëson bashkëshortja K. S. si trashëgimtare, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm CP nr.797/22, të datë 04.11.2022, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin CP nr.797/22, të datë 04.11.2022, ka vendosur: Aprovohet si i bazuar prapësimi i datës 19.10.2022 i debitorit NSH. Ç., ushtruar kundër Urdhrit Për Përmbarim CP.nr. 797/2022 i datës 27.12.2016, sipas propozimit për përmbarim CP.nr.797/2022 të datës 30.09.2022 të Gjykatës Themelore në Gjilan dhe i njëjti urdhër shfuqizohet.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar pala kreditore, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e parashtruar, dhe të anulohet i njëjti, të vërtetohet urdhri përmbarimor ose lënda të kthehet ne rivendosje

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtareve individuale, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën

Kontestimore, lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore dhe vëren se:

Ankesa e kreditorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, me datë 03.08.2022, ka paraqitur propozim për përbarim kundër debitorit, në bazë të dokumentit përbarimor, aktgjykimit C.nr.90/06, C.nr.198/06, C.nr.207/06, C.nr.225/06 të datës 11.04.2006.

Gjykata Themelore në Gjilan, duke vepruar në bazë të propozimit për përbarim të kreditorit, me aktvendimin CP.797/22 të datës 30.09.2022, ka lejuar përbarimin.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim kundër aktvendimit për lejimin e përbarimit nga gjykata, dhe e ka kundërshtuar në tërësi lejimin e përbarimit.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se Gjykata përmes Aktgjykimit C.nr./90/06 të dt. 02.05.2006, me të cilën është lejuar përbarimi, vërtetoi se i njëjti aktgjykim është i plotfuqishëm me datë 02.05.2006 ku kreditorit i është njohur e drejta që e ka kërkuar, por që i njëjti atë të drejtë nuk e ka realizuar në afatin 10 vjeçar, pasi që propozimin për përbarim e ka paraqitur më datën 03.08.2022, çka mund të vijmë në përfundim se kanë kaluar më tepër se 10 vjet, kur është bërë i plotfuqishëm aktgjykimi i cili kërkohet të përbarohet. Neni 3611 të LMD-së I(Nr. 04/L-077) si dhe nenin 379 të LMD-së të vitit 1978 në të cilat dispozita ligjore është paraparë se: "Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afate më të shkurtër për parashkrim" e në rastin konkret nga të cekurat më lartë mund të vijmë në përfundim se kreditorit i është parashkruar kërkesa, pasi që nga data 02.05.2006 kur është bërë i plotëfuqishëm aktgjykimi dhe i ekzekutueshëm, kanë kaluar më tepër se 16 vite. Prandaj për këtë arsye gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së. Nuk qëndrojnë pretendimet e kreditorit të parashtruara në ankesë, se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, neni 182.1 pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për aprovimin e prapësimit e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet.

Gjykata e shkallës së dytë pas shqyrtimit të ankesës, aktvendimit të ankimuar e në raport me provat nga shkresat e lëndës, gjeti se ankesa e kreditorit është e pa bazuar për faktin se duke pas parasysh aktgjykimin C.nr./90/06 të datës 02.05.2006, me të cilën është lejuar përbarimi, është bërë i plotëfuqishëm me datë 02.05.2006, ndërsa kreditori propozimin për përbarimin e aktgjykimit e ka parashtruar më datë 03.08.2022, rezulton fakti se kërkesa lidhur me propozimin e përbarimit nga kreditori është e parashkruar, sepse i njëjti me plotfuqishmërin e aktgjykimit i cili është object I përbarimit është i është njohur e drejta që ka kërkuar dhe se mos ndërmarrja e veprimeve lidhur me propozimin e të njëjtit aktgjykim për përbarim Brenda afatit të paraparë ligjor rezulton me prashkrimin e të njëjtës. Ky faktë vërtetohet me dispozitën e Neni 3611 të LMD-së, (Nr. 04/L-077) si dhe nenin 379 të LMD-së të vitit 1978 në të cilat dispozita ligjore është paraparë se: "Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës

ose me vendim të organit kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashihkon afata më të shkurtër për parashkrim" e në rastin konkret nga të cekurat më lartë mund të vijmë në përfundim se kreditorit i është parashkruar kërkesa, pa si që nga data 02.05.2006 kur është bërë i plotëfuqishëm aktgjykimi dhe i ekzekutueshëm, kanë kaluar më tepër se 16 vite. Nga kjo rrjedh se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbarimor.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të përsëritura të cilat drejtë i ka arsyetuar edhe gjykata e shkallës së parë, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është përcaktuar se "*në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual*".

Nga arsyet e paraqitura me lartë, Gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 paragrafi 1 pika (c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8648/2022, datë 06.03.2024

Gjyqtarja
Delushe Halimi